



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 359, Datë 30.12.2022

MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC BISHNICA 1, 2” SH.P.K., PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE, SHOQËRISË FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SH.A. DHE SHOQËRISË “HEC BISHNICA 1, 2” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20 gërma “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 23, pika 12 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 03.09.2016; Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016 dhe “Kontratës për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.06.2016, të ndryshuar; Vendimit të bordit të ERE-s nr. 89, “Mbi kërkesën e shoqërisë HEC “Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.) dhe HEC “Bishnica 1 dhe 2” sh.p.k.”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2022, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr. 2129/2 prot., datë 29.12.2022,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 89, datë 28.04.2022 është shprehur “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, Shoqërisë Furnizuesi i Tregut të lirë sh.a. dhe shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., dhe ka vendosur: *Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga Shoqëria “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Shoqërisë “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k. dhe Shoqërisë “FTL” sh.a., duke filluar -procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ne përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016.*

- Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar ndër të tjera vendosi:

“2/1. Vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i tregut të lirë”, sh.a. Këtyre prodhuesve me përparësi i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria “Furnizuesi i tregut të lirë”, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr.687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.”, dhe

1. Në pikën 5, fjalët 31 dhjetor 2022, “zëvendësohen me 30 qershor 2023”.

- Sikurse evidentuar më sipër, është vendosur Detyrimi i Shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, sh.a., dhe në pikën 2 është përcaktuar vijimi i gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, deri në datën 30 Qershor 2023.
- Meqënëse “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k. ka nënshkruar me shoqërinë FTL sh.a., Kontratën për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të bordit të ERE-s, të ndryshuar bazuar në VKM-në nr.650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar, aplikohet vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, sh.a.
- Këtyre prodhuesve përshirë dhe shoqërinë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k. i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me Vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, e cila zgjat deri më 30 qershor 2023”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

Vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e bordit të ERE nr. 89, datë 28.04.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, Shoqërisë Furnizuesi i Tregut të lirë sh.a. dhe shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqëritë FTL sh.a. dhe “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI